

MBI KOMBËSINË

DAVID MILLER

Prishtinë, CUNEUS (2022, ISBN 978 - 9951602341)

Libri *Mbi kombësinë* i autorit David Miller u botua për herë të parë në vitin 1995 (Oxford: Clarendon Press) dhe pas një çerekshekulli ai botohet edhe në gjuhën shqipe me përkthimin e Greta Avdytit. David Miller, i cili në atë kohë, ishte profesor i teorive politike në Universitetin e Oksfordit, bën një përsiatje filozofike mbi kombin dhe identitetin kombëtar, duke diskutuar mbi “parimin e kombësisë”. Sipas tij, ky parim nuk bie ndesh me parimet e lirisë individuale e as barazisë apo drejtësisë sociale, siç pretendohet nga shumë mendimtarë politikë të kësaj periudhe, përkundrazi kontribuon dhe i forcon ato. Kjo, pasi kombësia nuk duhet barazuar me ideologjinë nacionaliste. Gjithashtu ajo nuk i përjashton identitetet tjera kolektive (etnike, fetare, kulturore etj.). Thelbësore për ”parimin e kombësisë” dhe për atë çka e përbën kombësinë, janë tre qëndrime apo propozime kryesore, të ndërvarura e të

ndërthurura mes tyre; qëndrimi subjektiv, etik dhe qëndrimi politik. I pari pohon se kombësia mund të jetë element konstituiv i identitetit personal, që nuk është i përcaktuar vetëm nga një faktor i vetëm. Kjo nënkupton edhe që identiteti kombëtar nuk bie ndesh me identitetet tjera, sepse është identitet gjithëpërfshirës. Propozimi etik thekson se kombet janë bashkësi etike, të cilat ndikojnë në normat etike e morale, si dhe përfshijnë detyra të veçanta ndaj bashkëkombësve, që janë më të gjera e të ndryshme se ato ndaj qytetarëve në përgjithësi. Kjo nuk do të thotë se nuk ka detyrime fare ndaj njerëzve tjerë dhe se duhet t’i përjashtojë apo veçojë, por që për grupe të caktuara si, bie fjala, ushtarët, policët, sportistët, zyrtarët shtetërorë, pedagogët universitarë etj., kanë obligime për bashkëkombësit e tyre, para të tjerëve. Qëndrimin e tretë, atë politik, e lidh me të drejtën e kombit për vetëvendosje, si bashkësi politike me një territor të

caktuar, e cila sipas Miller-it, jo domosdo dhe me çdo kusht, duhet të rezultojë në krijimin e shtetit sovran, por më shumë nënkupton pavarësi politike. Elemente të tjera përbërëse për kombin sipas tij janë edhe karakteristikat e përbashkëta të kulturës, që nuk kufizohen vetëm në gjuhë, religjion apo kuzhinë, por edhe në praktikat të tjera kulturore, të cilat shkojnë në paralel me vazhdimësinë historike, të kaluarën e përbashkët me të cilën identifikohen pjesëtarët e kombit. Autori vëren: “[K]ur vlerësojmë identitetet kombëtare, duhet të shohim jo vetëm se në çfarë konsiston aktualisht identiteti, çfarë besojnë njerëzit se do të thotë të jesh italian apo japonez, por edhe procesin në të cilin ka lindur ai identitet.” (fq.55). Në përgjithësi parimi i kombësisë, sipas tij mbështet qytetarinë, të drejtat e njeriut dhe politikat demokratike më shumë se çdo lloj tjetër i identitetit kolektiv dhe pretendon se në shoqëritë multikulturore identitetet kombëtare, si dhe identitetet e grupet tjera, mund të bashkëjetojnë.

Ky sqarim i kombësisë me fjalë të tjera mund të përkufizohet

edhe si një formë e moderuar e nacionalizmit liberal, që përfaqësohet nga studiues e teoricienë si Yael Tamir, Amartya Sen, Michael Sandel, Will Kymlicka si dhe shumë filozofë të tjerë. Në kohën kur u shkrua libri, ai ishte pothuajse një zë i vetmuar dhe heretik në idenë e përbrendësismit të parimit të kombësisë si mendim dhe veprim politik. Bota e asaj periudhe ishte përfshirë në vrullin e globalizimit; Evropa po merrej me politikën e integritimeve, ndërsa situata e luftave të përgjakshme në Ballkan ishte ende aktive. Mirëpo, sot, me Brexit-in, me krizat financiare globale, me luftën në Ukrainë dhe me rritjen e forcave nacionaliste në shumë vende, shtjellimi idesë së kombësisë që parashtron Miller-i është një ftesë shumë me vlerë për të reflektuar rreth organizimit aktual politik, etik dhe shoqëror. Ai nuk mbron atë kombësi që është përjashtuese ndaj grupeve të tjera, as ata që e njëjtësojnë atë me përkatësi etnike apo fetare. Njëkohësisht, Miller kundërshton ashpër multikulturalizmin radikal, i cili promovon identitete politike dhe të drejta të veçanta për grupe të caktuara si zëvendësim i

bashkësisë kombëtare. Sipas tij, kultura publike dhe politika demokratike nuk mund të zhvillohen mirëfilli nëse mungon ndjenja e përbashkët dhe identiteti kombëtar që, nga ana tjetër, nxit edhe një mjedis më të përshtatshëm për drejtësi sociale dhe besim të ndërsjellë mes shoqërisë dhe institucioneve shtetërore. Gjithsesi, Miller-i është i vetëdijshëm që kombësia si parim nuk duhet shenjtëruar ose imunizuar ndaj kritikave të arsyeshme dhe se ka mjaft aspekte që duhen reformuar e duhet t'iu përshtaten rrethanave të caktuara. Sidoqoftë, ai vazhdon të besojë se identitetet kombëtare, përkundër globalizimit e fundamentalizmit, mbesin parimi i duhur mbi të cilën ne mbrojmë politikën demokratike dhe mirëqenien e qytetarëve.

E veçanta tek libri, është se trajtimi i nacionalizmit nuk hyn tërësisht brenda kuadrove teorike të nacionalizmit tashmë të njohura si: primordializmi, moderniteti apo etnosimbolizmi dhe Miller-i qëllimisht nuk lëshohet në debatet e pafundme dhe të pashterueshme të këtyre qasjeve. Ai arrin mjeshtërisht dhe me stil mjaft elegant ta vendosë

fokusin tek përkatësia kombëtare, jo vetëm si ideologji politike, por më shumë si besnikëri ndaj shtetit, dhe si ndjenjë e solidaritetit ndaj bashkësisë. Këtu Miller-i sjell rrëfimin e një miku të tij i cili kishte kuptuar rëndësinë e të qenurit holandez, vetëm pasi ekipi holandez i futbollit e mposhti ekipin gjerman në Kampionatin Europian të Futbollit, më 1988 dhe pa njerëzit duke festuar në rrugët e Amsterdemit (fq.29). Prandaj, a nuk jemi ne të gjithë dëshmitarë të kësaj ndjesie të krenarisë dhe dalldisjes emocionale, kur ekipi apo, siç edhe tekstualisht emërtohet kombëtarja, si në futboll, xhudo ose në çfarëdo disipline sportive apo fushëveprim tjetër, triumfojnë dhe dhurojnë nga një gjest simbolik të shqiptonjës me duar?

Prandaj, libri është tejet i rëndësishëm për të reflektuar ndaj situatës aktuale. Leximi i tij sot duket se është, më shumë se kurrë, i nevojshëm për të kuptuar se çfarë shteti e shoqërie duhet të ndërtojë.

Bekim Baliqi